







Vizioni



Bashkia Patos një bashki e sigurt dhe e aftë të përballojë risqet e fatkeqësive duke mbështetur kështu zhvillimin e saj të qendrueshëm. Një institucion i ndërgjegjshëm, me një nivel të lartë bashkëveprimi ndërsektorial për menaxhimin e fatkeqësive në të gjitha hallkat e saj: parandalim, gatishmëri, përgjigje dhe rimëkëmbje. Në linjë dhe e harmonizuar me politikat ndërkombëtare dhe kombëtare të zvogëlimit të riskut. Me një komunitet të informuar, të ndërgjegjshëm dhe të trajnuar, i gatshëm për të bashkëvepruar me institucionet në rastë rreziku.

